



**Republika e Kosovës**



**Kuvendi i Komunës-Vushtri**

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 23.02.2012 mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim lejohe transferimi i mjeteve në shumën prej 43,500.00 €, nga kategoria e investimeve kapitale, programi 644660, Planifikimi Urban dhe Mjedisor, kodi i projektit 86183, asfaltimi i rrugës "Dëshmorët e Kombit", shuma e projektit 870,000.00 €.

##### **Neni 2**

Shuma e cekur në nenin paraprak (43,500.00 €) transferohet në këto programe buxhetore:

- Kodi 180, në Drejtorinë për Shërbime Publike në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, në shumën prej 33,500.00 €;
- Kodi 730, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në kategorinë subvencione dhe transfere, në shumën prej 10.000.00 €.

##### **Neni 3**

Për zbatim in e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

##### **Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në kuvendin e komunës dhe pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 23.02.2012, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për sigurimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë

**Neni 2**

Diskusimi publik fillon nga data 24.02.2012 dhe zgjatë deri më 16.04.2012.

**Neni 3**

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

**Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muaji Prill 2012.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40.2”c” të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 “ç” të Statutit të komunës, Kuvendi i komunës në mbledhjen e mbajtur më 23.02.2012, mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE**  
**SUBVENCIONE**

**Neni 1**

1.1 Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës - fondi për transferë dhe subvencione për vitin 2012, në shumë prej 109.862 € të shfrytëzohen për destinimet e paraqitura si më poshtë:

1.1.1 Obligime të pakryera nga v. 2011.....3.000 €  
1.1.2 Për grupin parlamentar të femrave .....5.000 €  
1.1.3 Për Klubet sportive të komunës(28.300 €), prej të cilave:

- Kl. Basketbollit „Kosova“.....4.000 €
- Kl. Volejbollit „Kosova“ – femrat.....2.000 €
- Kl. hendbollit „Kosova“ meshkujt.....2.000 €
- Kl. hendbollit “Kosova” femrat.....2.000 €
- KV AS Vushtrria – meshkujt..... 500 €
- KF „Artakolli“..... 2.000 €
- KB“Vushtrria Basket” ..... 1.000 €
- K.Shahut „Llamkos“ ..... 800 €
- K SH „Shqiponja“..... 800 €
- KV.Gjinnazisti..... 2.000 €
- Kl. Mundjes Kosova“..... 500 €
- K Boksit „Kosova“ .....800 €
- Kl. Pingpongut „H.Prishtina“ .....500 €
- KF.“Kosova“ ..... 4.500 €
- KK-Box“Kosova“ ..... 1.000 €
- KH Samadrexha.....2.000 €
- Tifozët “Forca”.....800 €
- Shoqata e peshkatarëve “Silnica” ..... 300 €
- Shoqata e shurdh memeceve.....500 €
- Muhamet Rama, veteran i atletikës.....300 €

1.1.4 Për Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve.....	2.500 €
1.1.5 Për Shoqatën e Invalidëve .....	2.500 €
1.1.6 Për Shoqatën e Veteranëve .....	2.500 €
1.1.7 Për Shoqatën e të Burgosurve Politik.....	2.500 €
1.1.8 Për Shoqatën e Martirëve “Martirët e Lirisë” .....	2.500 €
1.1.9 Për Familjen e Selatin Gërxhaliut (Martiraj-ndihmë për ndërtim).....	6.500 €
1.1.10 Për familjen e Xhavit Hazirit (Druar – ndihmë për ndërtim).....	6.500 €
1.1.11 Për Familjen e Agim Saraçit (Vushtrri – ndihmë për ndërtim).....	6.500 €
1.1.12 Botim të librave.....	3.000 €
1.1.13 Ndhimë Sociale-Miell (familjeve skamnore).....	10.000 €
1.1.14 Ndhimja tjera (shërim, strehim etj.).....	23.062 €
1.1.15 Për Arsim (transport të nxënësve me aftësi të kufizuara).....	3.000 €
1.1.16 Shoqatës “Hendikos” .....	2.500 €

**Gjithsejt:.....109.862 €**

### **Neni 2**

Mjetet në shumën e cekur si në nenin paraprak të shpërndahen në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndhimë Momentale Entiteteve Publike dhe jo Publike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione të cilat me vendim të kuvendit të komunës iu janë nda në vitin 2011.

### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



**Republika e Kosovës**



**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 40.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 23.02.2012 mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për ndarjen e falënderimeve për disa kompani dhe OJQ**

##### **Neni 1**

Me këtë vendim autorizohet kryetari i komunës duke u bazuar edhe në nenin 67.1 “e” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, që të ndan falënderime për kompanitë dhe OJQ-të “Koha” dhe “Forca” që kanë bërë pastrimin e rrugëve lokale nga bora, gjatë periudhës emergjente, në Komunën e Vushtrrisë.

##### **Neni 2**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i komunës.

##### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi